



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Datë 29.05.2024

Lënda: Njoftim mbi përzgjedhjen e ofertës më të mirë, për përfitimin dhe kryerjen e shërbimeve me fonde buxhetore në kuadër të projektit për përmirësimin e aksesit së barabartë në shërbimet publike me standard të lartë nëpërmjet operacionit GOVTECH

**UNIVERSITETIT TË TIRANËS  
UNIVERSITETIT TË DURRËSIT “ALEKSANDER MOISIU”**

Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP) në vijim të procedurës “Për përfitimin dhe kryerjen e shërbimeve me fonde buxhetore në kuadër të projektit për përmirësimin e aksesit së barabartë në shërbimet publike me standard të lartë nëpërmjet operacionit GOVTECH”, bazuar në pikën 6 të VKM-së nr. 188 datë 13.03.2019 “Për ofrimin nga institucionet publike të arsimit të lartë (IAL) të shërbimeve, në përputhje me veprimtarinë e tyre, për institucionet e qeverisjes qendrore dhe institucionet në varësi të tyre”, ndryshuar, ka vlerësuar ofertat e paraqitura nga IAL-të publike si vijon:

**UNIVERSITETI I TIRANËS** - është vlerësuar me 78 pikë dhe vlerë 45,347,276 (dyzetë e pesë milion e treqind e dyzet e shtatë mijë e dyqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë.

**UNIVERSITETI I DURRËSIT “ALEKSANDER MOISIU”** – është vlerësuar me 60 pikë dhe vlerë 45.349.000 (dyzetë e pesë milion e treqind e dyzetë e nëntë mijë) lekë.

Nga sa më sipër Institucioni i Arsimit të Lartë Publik që ka paraqitur ofertën më të mirë është Universiteti i Tiranës, i cili do të ofrojë kryerjen e shërbimeve me fonde buxhetore në kuadër të projektit për përmirësimin e aksesit së barabartë në shërbimet publike me standard të lartë nëpërmjet operacionit GOVTECH.

Bashkëlidhur gjeni vlerësimin për dokumentacionin e dorëzuar, ku nëse nuk jeni dakord duhet ta ankimoni atë brenda 7(shtatë) ditëve.

Duke ju falënderuar,

**DREJTORI I PËRGJITHSHËM**

**Gerti JANAQI**